



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Raport për tremujorin e tretë 2022

Oda e Mjekëve të Kosovës



Nëntor 2022

Prishtinë

Përmbajtja:

Raport për tremujorin e tretë 2022	1
1. Këshilli Drejtues	3
2. Anëtarësimi	3
3. Mbikëqyrja etiko-profesionale.....	4
4. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional.....	5
5. Licencimet	6
6. Edukimi specialistik - zberthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të	6
7. Këshilli Mbikëqyrës.....	7
8. Komisioni për çështje Etike i OMK-së.....	7
9. Komisioni për Edukim Specialistik	7
10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke.....	7
11. Raporti financiar	7
11.1 Raporti financiar për periudhën deri me 30 shtator 2022.....	7
12.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional	9
12.3 Prokurimi.....	9
13 Aktivitete të tjera	10
13.1 Botimi i Revistës Mjeku.....	10
13.2 Konferenca e 14-të e EUPSA-s – Kirurgjia minimale invazive të fëmijëve.....	10
13.3 Kongresi i Dytë Klinik	11
13.4 Kongresi i IV-të i Mjekësisë- Diabeti Melit- Qasje interdisiplinare.....	11
13.5 Marreveshja per Delegimin e Fondeve dhe Implementim	12
13.6 Marrëdhëniet ndërkombëtare	13
13.7 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike	13
14 Plani i veprimit për vitin 2022	14

1. Këshilli Drejtues

Në periudhën kohore korrik-shtator 2022, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur tri (3) takime si dhe në 1 raste kanë votuar elektronikisht përmes e-mailit ku janë shqyrtuar lëndët si më poshtë:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën korrik-shtator	Vendimet/Përgjigjet sipas kërkesave/ ankesave të pranuar për periudhën korrik-shtator	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën korrik-shtator	Vendime/Pergjigje për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Këshilli Drejtues i Odës	14	11	0	- Vendime lidhur me ankesat/kërkesat e palëve	0

2. Anëtarësimi

Gjatë periudhës kohore korrik – shtator 2022, në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 105 mjekë, nga të cilët janë 6 mjekë të punësuar në sektorin publik, 23 mjekë të punësuar në sektorin privat, 71 mjekë të papunë dhe 5 mjekë në pension.




Tabela 1.1: Anëtarësime për periudhën kohore korrik - shtator 2022




Tabela 1.2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri më datën 30 shtator 2022

Gjatë kësaj periudhe janë ndarë nga jeta 7 mjekë si dhe janë rianëtarësuar 23 mjekë, si rezultat numri total i anëtarëve deri me datën 30 qershor është 4973 mjekë.

3. Mbikëqyrja etiko-profesionale


Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të Odës, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të odës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM 3	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën TM 3	Sanksionet e shqiptuara për periudhën TM 3	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën TM 3	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	5	13	N/A	N/A	14	13
Këshilli Etik	8	12	Rekomandime kolegjiale 3 (50.00€) Qortim Publik 6 (50.00€) Gjoha 1(1000.00€)	Qortim publik 6 (50.00€) Rekomandime kolegjiale 3 (50.00€) Gjoha 0 (0.00€)	7	3
Gjyqi i Nderit	0	0	///	///	0	0
Certifikatat e të kaluarës etike	59	///	///	///	///	///

Në shqyrtim të drejtpërdrejt, Gjyqi i Nderit nuk ka mbajtur takime për periudhën raportuese T3.


4. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë periudhës korrik - shtator 2022 ka akredituar 20 aktivitete. Në kuadër të aktiviteteve të akredituara, dy shoqata kanë bërë kërkesë për përkrahje financiare për organizimin e aktiviteteve dhe dy kërkesat janë aprovuar nga Komisioni.



5. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional gjatë periudhës korrik - shtator 2022, ka lëshuar 391 licenca me kategoritë si në grafikun e mëposhtëm:



6. Edukimi specialistik - zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të

Dizajnimi dhe fillimi i fazës kalimtare të zbërthimit të kompetencave të edukimit specialistik (zbërthimi ligjor, financiar dhe teknik) është në proces e sipër, duke përfshirë edhe hartimin e UA-së për shkollim specialistik.

Por në ndërkohë, bazuar në Nenin 9, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.7, të Ligjit për OPSH-të, si dhe Nenin 72, paragrafi 5, të Ligjit për Shëndetësi, OMK ka

kërkuar auditim të procesit pasiqë ka konstatuar dhe faktuar një mori shkeljeve ligjore. Procesi i auditimit ka filluar nga ana e MSh-së.

7. Këshilli Mbikqyrës

Gjatë periudhës korrik-shtator 2022 Këshilli Mbikqyrës i OMK-së ka mbajtur tre (3) takime ku i kanë shqyrtuar Vendimet e Këshillit Drejtues të OMK-së dhe të organeve të tjera të OMK-së.

8. Komisioni për çështje Etike i OMK-së

Në periudhën kohore korrik - shtator 2022, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar dhe shqyrtuar nëntë (9) kërkesa për leje për hulumtim.

Shtatë (7) kërkesat e parashtruara nga palët janë aprovuar, dhe aplikuesëve u janë lëshuar lejet për hulumtim, ndërsa dy (2) kërkesa komisioni i ka refuzuar.

9. Komisioni për Edukim Specialistik

Në periudhën kohore korrik - shtator 2022, Komisioni për Edukim Specialistik ka mbajtur një (1) takim. Përgjatë këtyre takimeve komisioni ka punuar rreth plotësim-ndryshimit të draft rregullorës për Edukim Specialistik si dhe ka përgaditur një shkresë.

10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke

Në periudhën kohore korrik - shtator 2022, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke ka pranuar tre (3) kërkesa për përkrahje financiare. Komisioni ka nxjerrë tre (3) vendime pas aprovimit të kërkesave të parashtruara nga palët si dhe për një rast të vdekjes së një anëtari kanë marrë vendim për ndarjen e mjeteve në emër shpenzimeve të varrimit sipas Rregullorës së Punës së Komisionit për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke të OMK-së.

11. Raporti financiar

11.1 Raporti financiar për periudhën deri me 30 shtator 2022

1.0 Të hyrat:								
1.1 Të hyrat e shtyera nga 2021	€	611,305.00						
Total të hyrat e shtyera nga 2021					€611,305			
1.1 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	Realizimi: TM3	TOTAL				
1.1.1 Të hyrat nga anëtarësia:								
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€	269,310	€	86,910	€	15,411	€	371,631
1.1.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€	3,050	€	5,060	€	1,500	€	9,610
1.1.4 Licencimi	€	34,825	€	27,280	€	18,560	€	80,665
1.1.5 Të hyrat e tjera*	€	10,806	€	19,932	€	22,873	€	53,611
1.1.6 Donacione për ndërtimin e obeliskut në nder të profesionistëve shëndetësor-Projekt i përbashkët i OPSH-ve	€	1,000	N/A		N/A		€	1,000
1.1.7 Projekti i LuxDEV	€	84,000	N/A		N/A		€	84,000
Të hyrat deri me 30.09.2022	€	402,991	€	139,182	€	58,344	€	600,517
Të hyrat e shtyera nga 2021							€	611,305
TOTAL TË HYRAT							€	1,211,822

2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	Shpenzimet: TM3	TOTAL				
2.1 Paga, medijtje dhe kontributet pensionale	€	64,278	€	68,039	€	47,017	€	179,334
2.2 Material shpenzues	€	830	€	1,313	€	953	€	3,097
2.3 Reprerentacioni	€	585	€	557	€	574	€	1,716
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€	2,920	€	11,507	€	57,639	€	72,066
2.5 Shpenzimet e tjera*	€	6,700	€	10,173	€	11,918	€	28,790
2.6 Shpenzimet e aseteve			€	600	€	6,580	€	7,180
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€	1,620	€	3,266	€	4,780	€	9,666
2.8 Xhironlogaria për ndërtimin e obeliskut në nder të profesionistëve shëndetësor-Projekt i përbashkët i OPSH-ve	€	53,856	N/A		N/A		€	53,856
2.9 Llogari të pagueshme	€	5,366	€	3,103			€	8,469
TOTAL SHPENZIMET 30.09.2022	€	136,155	€	98,558	€	129,460	€	364,173

TOTAL BILANCI € **847,649.65**

1.1.5*Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, Regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, Faksimili, Faksimili i dytë, Kongreset, simpoziumet, seminarët, konferenca vendore pa pjesëmarrje ndërkombëtare, aktivitetet e

organizuar nga kompanitë farmaceutike, Certifikatës për të kaluarën etike, Lejimi për hulumtime bio-mjekësore për anëtarë të Odës, Të hyrat nga dënimet (masat disiplinore), Dhurata / donacione, Të ardhurat të tjera .

2.5*Faksimili, Anëtarësimi në CPME, Shpenzimet e tel.,Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Pajisje të IT, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit,Shpenzimet e transportit, Inventari, Shpenzimet e tjera operative.

2.7*Tek përkrahja për solidaritet përveq mjeteve të ndara për mjekët të cilët kanë lënguar nga ndonjë sëmundje, janë të përfshira edhe mjetet e ndara për familjet e mjekëve të cilët kanë ndërruar jetë si pasoje e infektimit me virusin COVID19, bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues me nr. Ref. 53/20.

2.8* Në raportin financiar për periudhën derimë 31 dhjetor 2021, janë të përfshira edhe mjetet e menaxhuara nga OMK, të cilat janë në kuadër të projektit të përbashkët të Odave të Profesionistëve Shëndetësor, për ndërtimin e obeliskut “Për Jetën” kushtuar veprës dhe sakrificës së profesionistëve shëndetësor ndër dekada. Qëllimi i këtij njoftimi është se mjetet e bartur nuk janë pasuri e Odës së Mjekëve, por janë mjete të projektit i cili vazhdon edhe në vitin 2022.

12.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Oda e Mjekëve të Kosovës gjatë periudhës korrik - shtator 2022 ka akorduar përkrahje financiare për,

- Shoqatën e Kirurgëve Pediatrik të Kosovës me vlerë 8,700.00€ për bashkëorganizimin e Konferencës së 14-të të EUPSA-s – Kirurgjia minimale invazive të fëmijëve.
- Kolegjin e Kirurgëve të Kosovës me vlerë 32,000.00€ për bashkëorganizimin e Kongresit të dytë klinik.

12.3 Prokurimi

Gjatë periudhës kohore korrik - shtator 2022 u zhvilluan dy procedura të hapura të prokurimit, një procedurë e negociuar e prokurimit dhe një procedurë e prokurimit me vlera të vogla.

Në muajin shtator u zhvillua një (1) procedurë e hapur e prokurimit për furnizim me material shpenzues për zyret e OMK-së. Procedura e prokurimit u zhvillua me sukses dhe brenda afatit u lidh kontrata me operatorin ekonomik.

Në muajin shtator u zhvillua procedura e negociuar e prokurimit për përzgjedhjen e hapsirës për mbajtjen e eventeve të OMK-së. Procedura e prokurimit u zhvillua me sukses dhe brenda afatit u lidh kontrata korinizë për shërbime me operatorin ekonomik.

Në muajin shtator u zhvillua një (1) procedurë e hapur e prokurimit për Auditimin Funkcional dhe Financiar të OMK-së. Procedura e prokurimit u zhvillua me sukses dhe brenda afatit pritët të lidhet kontrata me operatorin ekonomik.

Gjatë muajit shtator u zhvillua me sukses procedura e prokurimit me vlera të vogla për krijimin e aplikacionit për regjistrimin dhe verifikimin e pjesëmarrësve në Kongres. Procedura e prokurimit u zhvillua me sukses dhe brenda afatit u lidh kontrata me operatorin ekonomik.

13 Aktivitete të tjera

13.1 Botimi i Revistës Mjeku

Gjatë periudhës Korrik- Shtator u publikua Revista Mjeku - Shëndeti mendor.

Në muajin Shtator u publikua vëllimi 2, numri 3 i Revistës Mjeku, me temën “Shëndeti Mendor”.

Revista përmban 20 artikuj, të përmbledhura në 61 faqe. Artikujt janë të shkruar nga Psikologë, Specialist të psikiatrisë, etj. Kalendar i aktiviteteve të EVP-së poashtu është i publikuar në këtë numër.

Revista është e publikuar edhe online në faqen e Odës së Mjekëve të Kosovës ([REVISTA MJEKU](#)) në mënyrë që të arrijë audiencë më të gjerë.

Ndërsa në muajin dhjetor pritet të publikohet numri i ardhshëm me temën Diabeti.

13.2 Konferenca e 14-të e EUPSA-s – Kirurgjia minimale invazive të fëmijëve

Shoqata e Kirurgëve Pediatrik të Kosovës së bashku me Odën e Mjekëve të Kosovës, me datë 13-14 Shtator, organizuan Konferencën e 14-të e EUPSA-s – Kirurgjia minimale invazive të fëmijëve.

Me datë 13-14 Shtator 2022, Shoqata e Kirurgëve Pediatrik të Kosovës dhe Oda e Mjekëve të Kosovës bashkëorganizuan Konferencën e 14-të e EUPSA-s (European Pediatric Surgeon’s Association-Asociacionit Evropian të Kirurgëve Pediatrik).

Konferenca me ligjerues ndërkombëtar mbledhi kirurgët pediatrik nga vendi, rajoni dhe Evropa për të diskutuar njohuritë më të reja në lëminë e Kirurgjisë Minimale Invazive dhe Urologjisë së Fëmijëve.

Ligjëratat dhe diskutimet u mbajtën nga ekspertë eminentë evropian dhe botërorë nga lëmia e Kirurgjisë Minimale Pediatrike dhe Urologjisë Pediatrike. Kjo konferencë edhe ka vënë kirurgët peditatik të Kosovës dhe Kosovën në hartë të kirurgjisë pediatrike botërore.

13.3 Kongresi i Dytë Klinik

Kolegji i Kirurgëve të Kosovës së bashku me Odën e Mjekëve të Kosovës, me datë 15-18 Shtator, organizuan Kongresin e Dytë Klinik.

Në këtë kongres u prezantuan tema të ndryshme prej të gjitha disiplinave kirurgjike nga mbi 100 prezantues me 143 prezantime. Nga ky numër i prezantuesve, 53 kanë qenë Ligjërues të Ftuar Ndërkombëtarë nga SHBA-të, Argjentina, Gjermania, Zvicra, Austria, Franca, Australia, si dhe nga vendet fqinje, si Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Bosnja dhe Hercegovina.

Ndërkaq, kanë marrë pjesë 58 ligjërues vendorë, që të gjithë ekspertë në fushat e tyre, numër të cilin synojmë ta rrisim për çdo Kongres.

Përgjat ditëve të kongresit ishin mbi 750 kirurgë nga të gjitha specialitetet kirurgjike, mjekësia emergjente dhe anesteziologjia.

13.4 Kongresi i IV-të i Mjekësisë- Diabeti Melit- Qasje interdisiplinare

Me datë 18-19 Nëntor 2022 pritet të mbahet Kongresi i IV Mjekësor, me rreth 2000 pjesëmarrës.

Gjatë periudhës Korrik - Shtator, Këshilli Organizativ dhe Këshilli Shkencor kanë definuar punëtoritë me temat që do të trajtohen, numrin e pjesëmarrësve dhe target grupet, përveç kësaj është përcaktuar të mbahet edhe një ligjeratë e veçantë me shkollat fillore dhe të mesme të vendit tonë.

Workshopet dhe ligjerata do të jenë si në vijim:

1. Pompa e insulinës pritet të i ketë 30 pjesëmarrës prej tyre do të jenë mjekë të fushave të ndryshme si në vijim: Endokrinolog, Pediatër-Endokrinolog, dhe specializantë të Endokrinologjisë.

2. Këmba diabetike pritet të i ketë 50 pjesëmarrës prej tyre do të jenë mjekë të fushave të ndryshme si në vijim: Endokrinolog, Kirurg vaskular, Mjekë familjar.

3. Ketoacidoza diabetike pritet të i ketë 50 pjesëmarrës prej tyre do të jenë mjekë të fushave të ndryshme si në vijim: Pediatër, specializantë të Pediatrisë, Mjekë familjar.

4. Ligjeratë për fëmijë dhe adoleshentë të shkollave fillore dhe të mesme, për ushqyerjen e fëmijëve të prekur me Diabet si dhe trajtimin e pacientëve të prekur me Diabet.

Hapja solemne e Kongresit të IV të Mjekësisë do të mbahet me datë 17 nëntor në Hotel Emerald Prishtinë, ndërsa punimet do të mbahen më 18-19 nëntor 2022.

Gjatë këtij tremujori ligjëruesit e ftuar nga vendet e ndryshme e kanë konfirmuar pjesëmarrjen në Kongres, ku edhe do të ndajnë eksperiencat e tyre shumëvjeçare në fushën e diabetit melit, duke shpalosur edhe të rejtat e fundit të kësaj lëmie.

Deri në këtë periudhë kanë aplikuar për pjesëmarrje mbi 1900 mjekë të fushave të ndryshme.

Poashtu janë pranuar 78 abstrakte vendore dhe të huaja dhe janë drejt finalizimit të procesit të punës.

13.5 Marreveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim

Oda e Mjekëve të Kosovës dhe projekti i Luxembourg Development KSV/017, kanë nënshkruar marrëveshje për delegimin e fondeve dhe implementimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ndërtimin e kapaciteteve të stafit mjekësorë të Spitaleve të Përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit dhe gjithashtu ndërtimin e kapaciteteve të stafit të OMK-së.

Në këtë drejtim Oda e Mjekëve në bashkpunim me Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit, kanë identifikuar nevojat për trajnime dhe si rezultat ka filluar procesin e rekrutimit të trajnerave të kualifikuar për të implementuar trajnimet e nevojshme.

Rrjedhimisht, faza e parë e trajnimeve do të organizohet gjatë muajit Tetor dhe Nëntor, ku do të mbulohen trajnimet në fushat si në vijim:

- Kursi për Dopplerin e enëve të gjakut
- Kursi për Echo transezofageale
- Kursi Ultratingulli i trurit dhe EEG (tek fëmijët)

- Kursi për punkcionin e gjëndrës tiroide
- Kursi për Ultrasonografinë abdominale
- Ultratingulli i artikulationit coxofemoral tek neonatët

Në bashkëpunim me menaxhmentin e Spitaleve të Përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit është bërë identifikimi i mjekëve sipas lëmive përkatëse dhe formimi i grupeve të mjekëve pjesëmarrës për këto trajnime. Për trajnimet e lartpërmendura pas shqyrtimit të aplikacioneve të pranuara është përzgjedhur grupi i trajnerëve që do të bëjë organizimin e tyre.

Gjithashtu, në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar me Lux Dev, është e përfshirë edhe ngritja e kapaciteteve të shërbimit profesional të OMK-së. Në fazën e parë janë planifikuar të organizohen më shumë trajnime të ndryshme gjithëpërfshirëse.

Gjithashtu gjatë muajit Tetor dhe Nëntor po planifikohet të organizohen vizita studimore në Odën e Mjekëve të Kroacisë. Qëllimi i kësaj vizite është e ngritja e kapaciteteve të ofrimit të shërbimeve profesionale dhe forcimi i rolit të këshilleve/komisioneve brenda odës.

13.6 Marrëdhëniet ndërkombëtare

Përfaqësues të Odës së Mjekëve të Kosovës morrën pjesë në takimin e përvitshëm të Odave të Mjekëve të Evropës Qendrore dhe Lindore, simpoziumi i 29-të i ZEVA-së.

Si çështje diskutimi gjatë takimit ishin temat lidhur me Karakteristikat kryesore të procedurave disiplinore në Odë, Apeli i ndërgjegjes dhe Kodi Etik Ndërkombëtar të Mjekësisë dhe Sfidat aktuale në sistemin spitalor, ku pjesë e këtyre diskutimeve ishte edhe Dr. Pleurat Sejdiu në prezantimin e raporteve rreth këtyre temave.

Ky simpozium ka zgjatur nga 8 deri më 10 shtator ku ishin të pranishëm edhe shumë përfaqësues të rëndësishëm të odave simotra Evropiane.

13.7 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore

sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së, Prokurori i OMK-së, Gjykatat Themelore ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën korrik-shtator	Vendimet sipas urdhëresave/kërkesave të pranuar për periudhën korrik-shtator	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën korrik-shtator	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprahe
Kryetari i Odës	1	1	1	0	0

14 Plani i veprimit për vitin 2022

Projektet afatmesme dhe afatgjata

- Projekti për ndërtimin e një objekti për të gjitha OPSH-të mbështetur nga MSH-ja, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë”. Kësaj iniciative i janë përgjigjur të gjitha OPSH-të dhe kërkesa zyrtare për mbështetje është nënshkruar nga të gjitha ato dhe më pas është dorëzuar në MSH. Fillimi i ndërtimit pritet pas dhënjes së përlqimit nga ana e ShSKUK-së dhe MSh-së për parcelën për ndërtim.
- Pas miratimit të kërkesës nga OMK drejtuar LuxDev-it lidhur me përkrahjen financiare për zhvillimin e sistemit informativ/bazës interaktive të të dhënave, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Kohëzgjatja e projektit është 1 vit.
- Zbërthimi dhe bartja e kompetencave për edukimin specialistik bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të.

- Botimi i numrave në vazhdimësi të “Revistës Mjeku”
- Organizimi i Kongresit të IV multidisiplinar me fokus diabetin